

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
“PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR KULTURËN 2026 -2030”

I. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Përmes një qasjeje të integruar të politikave publike, strategjia synon të forcojë rolin e sektorit kulturor si një faktor ndërsektorial që kontribuon në mirëqenien e qytetarëve, në zhvillimin territorial të balancuar dhe në konsolidimin e qeverisjes demokratike. Deri në vitin 2030, Shqipëria synon të konsolidojë pozicionin e saj si një qendër kulturore me rëndësi në Ballkanin Perëndimor dhe si një aktore aktive në hapësirën kulturore evropiane. Ky objektivi do të mbështetet në valorizimin e trashëgimisë së pasur kulturore dhe në zhvillimin e një ekosistemi të qëndrueshëm dhe dinamik krijues, i cili promovon pjesëmarrjen kulturore, nxit dialogun ndërkulturor dhe kontribuon në rritjen ekonomike të udhëhequr nga inovacioni dhe industritë kulturore dhe krijuese.

II. VLERËSIMI NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2026 - 2030”, është hartuar në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga programi i Qeverisë Shqiptare dhe angazhimeve të ndërmarra nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian (PKIE).

MTKS është angazhuar në përgatitjen e këtij projektvendimi, në përputhje me fushën e veprimtarisë shtetërore që ka në kompetencë, si organ përgjegjës për hartimin dhe zhvillimin e politikave kombëtare në fushën e trashëgimisë kulturore.

Ky projektvendim është planifikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projekt akteve (PPAP) të MTKS për vitin 2026.

III. ARGUMENTIMI LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky projektvendim ka si objektiv që deri në vitin 2030, Shqipëria të pozicionohet si një vend me kulturë bashkëkohore mesdhetare: një shtet që vlerëson diversitetin e tij historik dhe territorial si një burim inovacioni dhe dialogu. Vizioni i strategjisë duhet të mbështetet në idenë e një ekosistemi kulturor, në të cilin mbrojtja e trashëgimisë, prodhimi krijues, arsimit dhe kërkimi janë të ndërlidhura brenda një sistemi koherent të nxitur nga cilësia, bashkëpunimi dhe përfshirja.

Në kontekstin shqiptar, kultura duhet t'i përgjigjet tre sfidave kryesore:

1. Forcimit të kohezionit social dhe territorial
2. Ndërlidhjes me ekonominë dhe zhvillimin e qëndrueshëm
3. Zhvillimi i diplomacisë kulturore në nivel ndërkombëtar

Së pari, kultura mund të jetë një mjet i fuqishëm për përfshirjen sociale. Vlerësimi i trashëgimisë jomateriale, nga diversiteti gjuhësor te zanatet tradicionale, nënkupton njohjen dhe përqaftimin e pluralizmit kulturor të Shqipërisë, duke e shndërruar atë në një burim force dhe kohezioni. Projektet kulturore të bazuara në komunitet, shkollat e muzikës dhe të zanateve, si dhe programet e dedikuara për të rinjtë dhe gratë, mund të nxisin fuqizimin dhe pjesëmarrjen aktive qytetare.

Së dyti, kultura përbën një sektor ekonomik në rritje. Industritë kulturore dhe krijuese, si filmi, dizajni, videolojërat, botimet, artet interpretuese, zanatet dhe turizmi kulturor, gjenerojnë vlerë ekonomike, krijojnë vende pune të kualifikuara dhe nxisin inovacionin teknologjik. Mbështetja e këtij sektori nënkupton krijimin e kushteve për një ekonomi të bazuar në dije, të diversifikuar dhe të qëndrueshme, të rrënjësuar në identitetin kulturor.

Së treti, kultura shërben si një instrument i rëndësishëm i diplomacisë dhe i ndërtimit të imazhit kombëtar. Pjesëmarrja në rrjetet kulturore evropiane dhe ndërkombëtare, promovimi i trashëgimisë së njohur nga UNESCO dhe mbështetja e krijimtarisë bashkëkohore kontribuojnë në pozicionimin e Shqipërisë si një urë lidhëse midis Evropës dhe Mesdheut, një hapësirë dialogu, bashkëpunimi dhe vitaliteti kulturor.

Në këtë kuadër, strategjia do ta vendosë kulturën në thelb të politikave kombëtare të zhvillimit, si shtylla e katërt e qëndrueshmërisë, krahas dimensioneve ekonomike, sociale dhe mjedisore.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektvendim mbështetet në nenin 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE*

Ky projektvendim nuk synon përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Europian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Kjo Strategji Kombëtare e Kulturës 2026–2030 pasqyron muaj të tërë dialogu aktiv me artistë, administratorë kulturorë, akademikë, komunitete, sipërmarrës, të rinj, partnerë vendorë etj. në të gjithë vendin. Shqipëria ka një trashëgimi të jashtëzakonshme dhe potencial të madh krijues. Por ne gjithashtu e dimë, sepse profesionistët e kulturës na e theksojnë vazhdimisht, se ende mbeten shumë pengesa. Në mbarë vendin, institucionet funksionojnë brenda kuadrove që jo gjithmonë kanë ecur në hap me nevojat dhe ambiciet e shoqërisë sonë, si edhe me burime që shpesh janë më të kufizuara sesa kërkojnë misionet e tyre. Shumë artistë përballen me pasiguri. Pjesëmarrja kulturore e qytetarëve tanë, veçanërisht e të rinjve, mbetet nën mesataren evropiane. Ndërkohë, turizmi, një nga mundësitë tona më të mëdha ekonomike, ende nuk është integruar në mënyrë domethënëse me zhvillimin kulturor.

Ne u përgjigjemi këtyre sfidave duke kaluar nga ndërhyrjet e fragmentuara dhe të bazuara në projekte drejt një pakete koherente reformash dhe planesh veprimi që transformojnë në mënyrë strukturore sistemin kulturor.

Së pari, Strategjia përcakton një paketë të qartë reformash legjislative dhe rregullatore, duke nisur nga rishikimi i plotë i kuadrit ligjor kulturor dhe i Ligjit për Artin dhe Kulturën, modernizimi i normave për mbrojtjen e trashëgimisë, si dhe vendosja e Statusit të Artistit si një kuadër ndërsektorial. Këto reforma shoqërohen me ndryshime në legjislacionin fiskal dhe tatimor për ta bërë punën artistike më të qëndrueshme, me stimuj të rinj për sponsorizimin privat dhe investimet në kulturë, si edhe me riorganizimin e qeverisjes institucionale mbi bazën e autonomisë, llogaridhënies dhe menaxhimit të bazuar në performancë.

Së dyti, këto reforma operacionalizohen përmes planeve të integruara të veprimit nën tre shtyllat strategjike, secila e lidhur me objektiva konkrete, afate kohore dhe tregues të matshëm. Shtylla 1, Kultura si nxitëse e cilësisë së jetës, zbaton veprime që zgjerojnë aksesin e përditshëm në kulturë — duke modernizuar muzetë, forcuar qendrat kulturore dhe kujdestarinë komunitare, si dhe duke krijuar programe kombëtare për përfshirjen, leximin dhe pjesëmarrjen e të rinjve. Për më tepër, Strategjia promovon turizmin kulturor që shkon përtej monumenteve, duke ofruar përvoja autentike të krijimtarisë, artizanatit, arteve

skenike dhe trashëgimisë së përditshme. Shtylla 2, Kultura si mjet dialogu në nivel ndërkombëtar, i përkthen ambicet ndërkombëtare në instrumente për bashkëpunim, mobilitet, markim kulturor dhe eksport të krijimtarisë shqiptare, ndërsa Shtylla 3, Mundësimi i ekosistemit kulturor, konsolidon kushtet mbështetëse përmes ngritjes së kapaciteteve, platformave digjitale, mekanizmave të rinj të financimit dhe instrumenteve të posaçme të qeverisjes, si Njësia e Koordinimit të Politikave Kulturore dhe udhërrëfyesi i reformës ILGA.

Së treti, Strategjia i transformon nevojat në mundësi duke harmonizuar reformat dhe veprimet brenda një kuadri financiar afatmesëm që rrit gradualisht investimet në kulturë drejt niveleve evropiane, diversifikon burimet e financimit dhe planifikon zbatimin përgjatë periudhës 2026–2030. Në këtë mënyrë, dobësitë strukturore — nëninvestimi, boshllëqet ligjore, centralizimi, tregjet e dobëta dhe pjesëmarrja e ulët — trajtohen jo si kufizime statike, por si pika nisjeje për një tranzicion të planifikuar drejt një ekosistemi kulturor modern dhe të harmonizuar me BE-në. Ky kuadër financiar afatmesëm parashikon një investim mesatar vjetor prej rreth 10 miliardë lekësh, ku afërsisht 70% sigurohet nga Buxheti i Shtetit (duke kombinuar racionalizimin e alokimeve ekzistuese me fonde të reja të synuara), ndërsa 30% e mbetur mobilizohet nga programet e BE-së, partnerët ndërkombëtarë, investimet private dhe kontributet e diasporës.

Sot, Shqipëria alokon rreth 0.3–0.5% të PBB-së për kulturën dhe rekreacionin, ndër nivelet më të ulëta në Evropë dhe më pak se gjysma e mesatares së BE-së prej afërsisht 1.2% të PBB-së. Përmes kësaj Strategjie, Shqipëria angazhohet ta dyfishojë këtë përqindje gjatë pesë viteve të ardhshme, duke synuar të arrijë të paktën 0.8% të PBB-së, në përputhje me shtete të krahasueshme të BE-së si Rumania, Bullgaria dhe Italia, dhe në afatgjatë drejt nivelit 1–1.2%.

Deri në vitin 2030, vizioni ynë është i qartë: çdo qytetar, pavarësisht vendndodhjes apo prejardhjes, duhet ta përjetojë kulturën si pjesë të jetës së përditshme. Profesionistët e kulturës duhet të jenë në gjendje të ndërtojnë karriera të qëndrueshme në Shqipëri. Pasuritë e trashëgimisë duhet të marrin burimet dhe ekspertizën e nevojshme për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të tyre. Muzetë duhet të funksionojnë si qendra dinamike të të nxënit, arkivat duhet të digjitalizohen dhe të jenë të aksesueshme, partneritetet në artet skenike të forcohen dhe skena e pavarur krijuese të fuqizohet për të inovuar.

Progresi do të monitorohet përmes një kuadri kombëtar monitorimi, me një rishikim formal afatmesëm në vitin 2028 dhe me raportim vjetor në Këshillin e Ministrave dhe Kuvend, duke matur rezultatet në pjesëmarrjen kulturore, punësimin kulturor, gjendjen e trashëgimisë dhe barazinë territoriale.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe institucionet në varësi të saj.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim është hartuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit me mbështetjen teknike të Agjencise Italiane të Zhvillimit nëpërmjet Fondacionit Santagata.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Mbulimi financiar për Strategjinë Kombëtare të Kulturës 2026–2030 të Shqipërisë është hartuar sipas tre skenarëve: bazë, progresiv dhe optimal. Llogaritjet i japin përparësi burimeve të jashtme financiare nga partnerët ndërkombëtarë, të përzgjedhura për shkak të rritjes së tyre të konsiderueshme historike dhe mungesës së parashikimeve për rënie, pavarësisht paqëndrueshmërisë globale. Kjo qasje synon të garantojë financim të qëndrueshëm në kushtet e sfidave ndërkombëtare. Këto fonde, në fakt, kanë treguar rritje të fortë historike dhe ruajnë projeksione të qëndrueshme edhe në një kontekst gjeopolitik të paqëndrueshëm, duke u bërë shtylla kryesore për zbatimin e strategjisë. Rishpërndarja e brendshme nga Buxheti i Shtetit e plotëson këtë financim, ndërsa burime të reja, si taksat e turizmit dhe të ardhurat nga biletat, ofrojnë stabilitet shtesë.

Strategjia përcakton një objektiv afatmesëm për arritjen e 1-1,2% të PBB-së të dedikuar për kulturën dhe rekreacionin në planin afatgjatë në përputhje me mesataren e BE-së dhe me shtete si Rumania dhe Bullgaria, por edhe Italia, duke dyfishuar në mënyrë efektive nivelin aktual të investimeve dhe duke e vendosur Shqipërinë në një trajektore të qëndrueshme drejt mesatares evropiane.

Modeli financiar i Strategjisë është ndërtuar mbi tri rrjedha plotësuese financimi që sigurojnë si vazhdimësi ashtu edhe inovacion në financimin e sektorit:

1. **Fondet ekzistuese për kulturën**— që korrespondon me afërsisht 4 miliardë lekë në vit, që përfaqëson mesataren historike të alokimeve kombëtare për

artet, kulturën dhe trashëgiminë. Këto burime do të ridrejtohen dhe racionalizohen pjesërisht për t'u përshtatur me prioritetet e reja strategjike dhe për të maksimizuar ndikimin e tyre.

2. **Shpërndarje të reja publike**— burime shtesë buxhetore që do të mobilizohen nga Ministria, veçanërisht në fazën fillestare të zbatimit (2026–2027), për të mbuluar forcimin institucional, projektet kryesore dhe investimet në infrastrukturë.
3. **Burime të jashtme dhe plotësuese**— duke përfshirë fondet ndërkombëtare, stimujt fiskalë, partneritetet publik-privat dhe mekanizmat e mbledhjes së fondeve. Këto do të shfrytëzojnë kontributet nga programet e BE-së dhe donatorët dypalësh, si dhe skemat kombëtare të stimujve tatimorë dhe nismat e angazhimit të diasporës.

Strategjia së pari përcakton nevojën për të rritur në mënyrë të qëndrueshme këtë alokim në 7 miliardë lekë në vit, duke rritur gradualisht buxhetin total të MTKS-së, me fokus në komponentin kulturor.

Me koston vjetore të vlerësuar të Strategjisë në rreth 10 miliardë lekë, Shteti do të kontribuonte me 70%, ndërsa fondet e BE-së, IPA III, Banka Botërore dhe bashkëpunimi dypalësh i donatorëve do të siguronin pjesën tjetër, të plotësuar nga donacionet, sponsorizimet, stimujt tatimorë dhe mbledhja e fondeve nga diaspora që kontribuojnë përkatësisht me 15% dhe 10%. Me kalimin e kohës, ndërsa kontributet e jashtme rriten, ndarja e drejtpërdrejtë e buxhetit të Shtetit për zbatimin e strategjisë mund të ulet në përputhje me rrethanat.

| Burimi i Financimit | Përshkrimi | Pjesa e vlerësuar (2026–2030) |
|---|---|--------------------------------------|
| Fondet e rialokuara nga Buxheti i Shtetit | Një fond bazë prej afërsisht 4 miliardë lekësh në vit, i ridrejtuar drejt prioritetëve strategjike. | 40% |
| Buxheti i Shtetit Alokime të reja | Rritje vjetore prej 3 miliardë lekësh (2026–2027) për fazën fillestare, pastaj stabilizim. | 30% |
| Fondet Ndërkomb | Fondet e BE-së, IPA III, Banka Botërore dhe | 15% |

| | | |
|--------------------------------------|--|-----|
| ëtare dhe të BE-së | bashkëpunimi dypalësh i donatorëve. | |
| Stimuj privatë dhe fiskalë | Donacione, sponsorizime, stimuj tatimorë dhe mbledhje fondesh nga diaspora. | 10% |
| Partneritete t Publiko-Private (PPP) | Investime të përbashkëta në infrastrukturën kulturore dhe qendrat e inovacionit. | 5% |

Zbatimi i Strategjisë parashikon një trajektore financiare me dy faza:

Faza 1: fillimi dhe nxitja për zbatimin e Strategjisë (2026–2027)

Gjatë dy viteve të para, Strategjia kërkon një rritje të shpenzimeve totale vjetore nga 4 miliardë lekë në afërsisht 7 miliardë lekë, që korrespondon me një nxitje buxhetore që synon fillimin e programeve kryesore, masave për ndërtimin e kapaciteteve dhe investimeve në infrastrukturë.

Faza 2: Konsolidimi dhe Qëndrueshmëria (2028–2030)

Nga viti 2028 e tutje, buxheti vjetor pritet të stabilizohet në një nivel të qëndrueshëm, me një kontribut të balancuar midis financimit shtetëror, bashkëfinancimit ndërkombëtar dhe pjesëmarrjes së sektorit privat. Diversifikimi progresiv i burimeve të të ardhurave do të zvogëlojë gradualisht varësinë nga shpenzimet publike të drejtpërdrejta, duke siguruar qëndrueshmëri ekonomike.

X. HYRJA NË FUQI.

Ky projektvendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR

BLENDI GONXHJA